

# PËRPARIMI

Reviste kulturore

ФЕДЕРАЦИЈА  
АРБАНСКА  
ИНА СРОЈ 4334  
СИГН. 181/62

NUMER 5

Maj 1956

VJETI II

## ANTARET E REDAKSIS:

Ismet Shaqiri, Hivzi Sulejmani, Vojislav Dançetoviqi, Elhami Nimani,  
Mehmet Hoxha, Stathi Kostari, Abdullah Zajmi, Mehmedali Hoxha, Lorenç Antoni,  
Mehdi Bardhi, Xheladin Topçiu, Ali Rexha, Mark Krasniqi,  
Jusuf Shushka, Hasan Vokshi, Ismet Mula, Shevqet Veliu,  
Masar Murtezai

## KËSHILLI REDAKTUES:

Stathi Kostari, Ali Rexha, Xheladin Topçiu, Hasan Vokshi

## DREJTORI PËRGJEGJËS

Elhami Nimani

## PËRMBAJTJA:

Dr. JOZHE POTRÇ:

Familja socialiste

Dr. JOVAN POPOVIĆ:

Elementet e gjuhës greqishte në shqipet

VLLADIMIR STOJANÇEVIQ:


Kosova e Metohija nën sundimin turk  
1878-1912

JASHAR REXHEPAGAJ:

Kush duhet ta organizojë mësimin  
e edukatës shoqore e morale

JOVAN NESHIQ:

Disa probleme të mësimit të historis



## ELEMENTET E GJUHËS GREQISHTE NË SHQIPET

Nëse vështrojmë ndikesën e gjuhës greqishte në gjuhët tjera të Ballkanit, atëherë do të vijshim në përfundim se në kët pikëpamje gjuha shqipe ndryshon prej gjuhëve të Sllavëve të jugut dhe prej asaj turqishte. Sepse, ndërsa Jugosllavët e Turqit, sikurse dihet, kanë pësue vetëm ndikesën e greqishtes së ré, mbasi kanë ardhë relativisht vonë, — Shqiptarët në gjuhën e tyne kanë dy shtresa greqishte të ndryshme: shtresën mā të vogël të greqishtes së vjetër dhe atë mā të madhe të greqishtes së ré.<sup>1)</sup> Sa u përket Romakëve, ka gjasë se edhe ata në kët pikëpamje përkojnë me Shqiptarët, sepse edhe ata janë disi autoktonë në Ballkan; por shkenctarët rumunë deri më sod s'kanë mundë me tregue me argumente të shëndosha shtresën e greqishtes së vjetër në gjuhën e tyne.

Me mijë vjetë Grekët kanë qenë popull udhëheqës kulturre në Ballkan, e prandej âsht fare e natyrshme se në të gjitha kohët kanë ushtrue ndikesë të fortë gjuhsore ndaj të gjithë popujve tjerë të Ballkanit, ndaj „barbarëve” (dmth. „të huejve”). Fundi i fundit, shkenctarët kanë dijtë kaherë se në gjuhën shqipe gjinden elemente të greqishtes së ré. Mirëpo shkenca e mëparshme mohonte se në gjuhën shqipe egzistojnë edhe elemente të greqishtes antike (dmth. të greqishtes së vjetër). Madjë edhe pioneri i madh i albanologjis Gustav Meyer-i pohonte kështu: „Me sa shof unë, gjuha shqipe s'përmban fjalë të huajtuna prej greqishtes së vjetër”. Ky ka qenë mendim i gabueshëm, dhe mund të justifikohet deri diku me tezën e vjetër se Shqiptarët janë mbasardhsa t’Ilirëve, e jo të Thrakasve. Mbasi Ilirët kanë pasë banue në perëndim të Ballkanit, e jo në lindje, s’do t’ishte e logjikshme — konsideronte albanologjija e vjetër — të kenë ra nën ndikesën e gju-

<sup>1)</sup> Shtresa e greqishtes së ré dahet në të vërtetë në dy grupe: n’atë të greqishtes së mesme (të Bizantit) dhe të greqishtes së ré të mirëfilltë (periudha e sundimit turk); por, zakonisht, shkenca të dy grupet i përfshin me termën *greqishte e ré*, përkundrejt *greqishte e vjetër* (antike).

hës greqishte, sepse Grekët kanë banue gjithmonë kryesisht në lindje të Ballkanit.

Mirëpo shkenctarët — poashtu Gjermanët — filluen me e shique më drejt problemin e fjalëve të greqishtes së vjetër në gjuhën shqipe. Kështu Stier-i, Schuchardt-i dhe Bugge-i zbuluen nji sasi fjalësh shqipe me originë prej greqishtes së vjetër, e mandej helenisti gjerman Albert Thumb (shqipto: Tumb) në vjetin 1909, në nji artikull mjaft me randsi, analizoi në mënyrë kritike tanë materialin dhe nxuerr përfundim të paluetjtshëm: se në gjuhën shqipe ka nji sasi fjalësh, që rrjedhin pa farë dyshimi prej greqishtes së vjetër. Dhe ky rezultat i Thumb-it egziston deri më sod si n'albanologji ashtu edhe në helenistikë.

Nëqoftëse duem me i përbledhë rezultatet e Thumb-it me nji fjalë të vetme, atëherë mund ta formulojmë kështu: ndikesa e greqishtes së vjetër në gjuhën shqipe nuk është as afërsisht aq e fortë, sa ajo latinishte, por është mjaft e vjetër, ndoshta edhe më e vjetër se ajo latine.

Analiza fonetike e fjalëve të greqishtes së vjetër në gjuhën shqipe, tregon më nji anë se këto fjalë greqishte kanë hyrë në gjuhën shqipe qysh para proceseve gjuhsore greqishte në kohën e Bizantit, e m'anë tjetër se kanë pësue ndikesë të disa ligjëve gjuhsore shum të vjetra thjesht shqipe. Na këtu s'mund të hyjmë në hollsina, por prap se prap do ta tregojmë kët pohim me anë të njij shembulli. Të marrim fjalën *mok(ë)në*; tosk, *mokërë*, që është fjalë e huajtun shum e vjetër prej asaj greqishte *makhana* (n'Athinë *mekhane*). Sod kjo fjalë greqishte thuhet *mihani*, pra përmban *h*, e jo *k*. Prandej ky është shëj i sigurtë se Shqiptarët e kanë marrë kët fjalë prej Grekëve qysh kur shqiptohej *k* (e jo *h*), e në linguistikë dihet se kjo ka qenë para krijimit të Bizantit, domethanë më së largti kah fillimi i epokës së rë, e sigurisht shum para ardhjes së Sllavëve në Ballkan. N'anën tjetër ndrrimi i *a-s* së gjatë në *o* (*mokënë* prej *makhana*, pra, poashtu sikurse *motër* në marrëdhhanje më fjalën latinishte *mater*, sllavisht *mati*) dhe „rotacizmi“ toksnisht (ndrrimi i *n-s* në *r*) — dëshmojnë përsëri përvjetërsin e madhe, sepse gjinden në fjalët greqishte dhe latinishte të gjuhës shqipe, ndërsa në fjalët sllavishte, turqishte dhe italishtë — nuk gjinden.

Tue shique tash materialin e greqishtes së vjetër në gjuhën shqipe, do të mundemi me konstatue se ndikesa e greqishtes së vjetër ka qenë më së forti ndikesë kulturore, domethanë se fjalët me këso origjine që kanë marrë Shqiptarët (dmth. të parët e tyne Thrakasit) — kanë qenë më së pari terma kulturore.

Sidomos âsht karakteristike se te Shqiptarët gjindet nji varg i tanë emnash të bimëve të kultivueme me origjinë prej greqishtes së vjetër: *qershí*, *lakën* (*lakér*), *pjepën* (*pjepér*), *presh*, *sherp*, geg. *mërajë* (tosk. në Greqi *maraj*), motërgonë (dhe variantet), *lëpjetë* (dhe variantet). Si thotë Thumb-i, kjo dukuni nuk âsht e rasës, por vjen nga të përhapunit e ushqimit mâ të mirë e mâ të kulturuem prej Greqije në viset tjera të Ballkanit.

Pos kësaj terminologjije mund të përmenden edhe dy atri terma kulturore: fjala e naltpërmendun *mokënë* (domethanja zanafillse „maqina”), *drapën* (*drapér*), *ipeshkv* (*episkopos*), mandej asosh mitologjike: *djall*, *djemën* dhe *Mauthi* (Elbasan. emni i ndonji zane) prej *Amaltheia*-it, dhe mâ në fund fjalët: *shpellë*, *liqê* (*liqe-ri*), *krua*, *fir* (*fjer*), *bretk*, *labrik* (*peshku labrax*), *shkarpë*, e sigurisht edhe disa tjerë.



Po theksoj edhe njiherë se ndikesa e greqishtes së vjetër nuk âsht aq e fortë, por shum e vjetër dhe besnike. Kjo do të thotë se Thrakasit (Shqiptarët e mâvonshëm) kanë qenë q’prej

kohësh në kontakt me Grekët e vjetër, mirëpo ky kontakt nuk ka qenë aq intim, por mjaft i dobët. Nëqoftëse i marrim para-sysh këto fakte, si edhe faktin se ndikesa latine simbas gjasës, âsht diçka mâ e re (por për këtë do të flas njiherë tjetër), — atëherë mundemi me caktue me të vërtetë atdheun e parë të Shqiptarëve dikah kah viset mâ lindore të Ballkanit, ku në filim nuk ka pasë rryma latine; ky teren s'ka mundë me qenë shum larg prej Greqis. Me fjalë tjera: prap vijmë në faktin se atdheun e Shqiptarëvet (dmth. t'atyne fiseve thrakase prej të cilave kanë rrjedhë Shqiptarët) — duhet kërkue, praktikisht, në Maqedoní, në Sërbin jugore etj. (emnat sllave *Nish*, *Ohrid* e *Shtip*, fundi fundit janë me origjinë shqipe). Krahas është hartën.

Mbas epokës antike — ndikesa greke në gjuhën shqipe, jo vetëm se vazhdoi, por edhe u forcue. Kjo âsht fare e natyrshme. Sepse, deri sa shtetet e vogla të Greqis së vjetër, me kulturë të naltë, por të dobta politikisht, mundën me përhapë ndikesën e tyne te popujt e Ballkanit, âsht e qartë që këtë do ta bante, madjë edhe në masë mâ të madhe Greqija mesjetare, e cila u bâ monarkí e fortë — perandorí e Bizantit. Ndikesa e greqishtes së ré, gjatë epokës bizantine, nuk u shtri vetëm te Shqiptarët, por edhe te Sërbët, Bullgarët, Rumunët, e më vonë edhe te Turqit. Mund të thuhet se e tanë terminologjija kulturore te Sërbët e Bullgarët, gjatë Mesjetës ka qenë me origjinë greke. Kuptohet se, shum sosh u shtinë edhe te Shqiptarët, aq më parë, mbasi Shqipnija ra shum herë nën sundimin e perandorëve bizantinë. Edhe mbas ramjes së Bizantit, kultura greke qëndroi edhe më, por në nji formë të ndryshueme, prandej ndikesa e greqishtes së ré u shtrî edhe në gjuhën dominuese turke si edhe në gjuhët e popujve të robnuem të Ballkanit. Pra, mund të thuhet se ndikesa e greqishtes së ré në gjuhën shqipe vazhdoi q'prej formimit të Shtetit bizantin e afërsisht deri para njiqind ose dyqind vjetësh.<sup>1)</sup>

Natyrisht, të gjitha fjalët e greqishtes së re nuk kanë hyrë të njajtën kohë në gjuhën shqipe: disa janë më të vjetra, disa më të reja, e do tjera fare të reja. Shpeshherë kjo gjâ mund të vihet re edhe me anë t'analizës. Kështu prej fjalës greqishte *kalogeros*, rrjedhin dy variante shqipe: *kallogjer* dhe *kallojer*, prej së cilave e para âsht më e vjetër (*gj*), kurse e dyta më e re (*j*). Marrun në përgjithsí, mund të konsiderohet parimi, se janë më të vjetra ato greqizma të reja të gjuh-

<sup>1)</sup> Analizën e vazhdimit të ndikesës së greqishtes së ré te Sllavët e Jugut e kam bâ në studimin tem „Problemi i kronologjisë së fjalëve të huajtura bizantine dhe të greqishtes së ré në gjuhën sérbe”, Zbornik Vizantološkog instituta SAN III, fq. 117-156.

hës shqipe, të cilat kanë depërtue edhe në *dialektin gëgnisht*, ndërsa janë më të reja ato që gjinden vetëm në mbarë Tosk-nin ose madjë vetëm në viset jugore, dmth. afër kufinit gjuh-suer bashkohuer ndërmjet Shqiptarëve e Grekëve, megjithse edhe këtu ka përjashtime. Përveç kësaj, âsht rasë e zakon-shme se fjalët e greqishtes së re mbërrijnë në Gegni me anë të dialektit tosknisht; por edhe këtu ka përjashtime.

Për ndikesën e greqishtes së re në gjuhën shqipe, mund të thuhet gjithashtu se ajo në rend të parë âsht ndikesë kul-turore dmth. se përfshin shprehje të ndryshme të kulturës ma-teriale ose të superstrukturës. Kët gjâ do ta konstatojmë afér-sisht, nëqoftëse marrim një pjesë të këtij materiali. Nji mate-rial kësodore mundemi me e gjetë në greqizmat (të Mesjetës dhe më vonë), që janë pak a shum të përgjithshme në gjuh-ën shqipe.

Si te Sërbët, Bullgarët e Turqit, ashtu edhe te Shqiptarët kultura materiale âsht nën ndikesën e fortë mesjetare (e të mëvonshme) greke.

Para së gjithash arqitektura: *qeremide*, *plit*, *themel* (forma temel ka ardhë me anë të sërbishtes!), *dhomë*, *qeli*, *perivol* (*pi-livol* = „pergola” pjergull), *pirc* („kulla”), *katue*. Dhe vegla e muratorëve: *mistri*.

Mandej disa pjesë orendish: *krevat* (trajta krevet vjen me anë të turqishtes), *kathedër* („shtrat i bashkëshortëve”, në Mirditë).

Gjithashtu edhe një numër i madh veglash kanë emna t’o-  
rigjinës greke *shtyllë*, *koraq*, *hamurik*, *hingzë*, kací mandej za-vë, *pirû*, *kremaster* („vargoj”, n’Elbasan). Emna enësh së ndry-shme: *kondir*, *putir(ë)*, *bucak*. Disa sende tjera për nevojat e njeriut: *kandil*, *mësallë*, *sapun* ndoshta nepërmjet të sllavish-tes: *krahasò sapunitë* (prej sërbishtes *sapuniti*), *kundurë*, *ku-ndër*, *kopane*, *llastik*, *litar*.

Si te Serbët, ashtu edhe te Shqiptarët mulltarija âsht nën ndikesën greke, për të cilën dëshmojnë shprehjet: *paskajë* greg-  
qisht *paspali* dhe *pitar* (simbas Cordignano „sorta di polenta  
sottile” = një lloj qulli i hollë — sh. përkth.).

Kjo vlen mjaft edhe për komunikacion, tue marrë para-sysh fjalët: *drom*, *dromisë* dhe *samar*, mandej *karaf* („lundër”; prej *karabion*), *gumë*, *kaprros*.

Poashtu edhe shërbimi bankar në Ballkan ka qenë nën ndi-kesën e greqishtes: krahasò *kamatë*, mandej *paren* e imtë *aster* (?).

Edhejeta shoqnore, politike dhe psikologjike âsht zhvi-llue te Shqiptarët në ndikesën e Bizantinëve, për çka dëshmon nji varg i tanë fjalësh të huajtuna prej greqishtes: *argat* (*argatë*), *pronë* (*pronar*, *pronue*; kjo âsht *pronia* e famshme bi-

zantine), *sinjuer* (-ori) „arë”, *nikoqir* („zot shtëpije”), *plaçkitë* (*plaçkadirë*), *pajisë*, *qeverisë* (dhe variantet, sikurse âsht edhe fjala sllavishte *sundue*), *fron*, *doke* (?; sikurse edhe fjala *zakon* me origjinë sllavishte). Edhe shkenca e kultura pjesërisht u detyrohet Grekëve: *dhaskal*, *llogari*; por gjithashtu edhe kategorinat e ndryshme psikologjike kanë emna grekë: *hir*, *frigë*, *këndis*, *zili*, *pezm* (*pezmatue*), *palavi* (*palavue*), *horjat* (nëpërmjet të turqishtes?).

Mandej vlen me përmendë kishën orthodokse, e cila, sikurse dihet, âsht krijesë greke. Vërtetë, termat e kishës greke janë përhapë veçanisht në jug, për shembull rrëth Korçës, ku edhe sod popullsija âsht e besimit orthodoks (krahasimi për këtë mât poshtë), por disa shprehje janë edhe mât të përhapuna *monastir* (*mundështir*), *liturgjí*, *ikonë* (nepërmjet të sërbishtes?), *dhespot* („peshkop orthodoks”), *katërrue*, *psalm*, *psalterë*. Mandej edhe mitologjija pagane: *mëngjí* etj., *stuhí*; prej kësaj shprehjeje ka rrjedhë dhe *duhí* (erë), dhe *mëngjisë* („mjakue”).

Asht për të na çuditë fakti që gjejmë edhe shprehjen *rrig* „prifti (krajli) në letrat e lojës”, që natyrisht, ka rrjedhë prej latinishtes *rex* (*regis*) por me anë të greqishtes së ré *rigas*.

Mirëpo, përveç shprehjeve teknike e shoqnore në gjuhën shqipe ka edhe mjaft fjalë me origjinë të greqishtes së ré. Përsëri gjejmë bimë (shumica të kultivueme): *spanaq / spinaq*, *pras* (prej *prason*; prej së njajtës fjalë âsht mât e vjetra *presh*, shif mât sipër; trajta *praz* ka ardhë me anë të sërbishtes), *fasul* (trajta *pasul* prej sërbishtes), *drandofille*, *makedhonis* (Elbasan; trajta *magdanos* ka ardhë nepërmjet të turqishtes), *qepariz* (vetëm në domethanjen „*populus domesticus*” — te Mjedja). Simbas mendimit të disave edhe fjala *lule* e ka origjinën prej greqishtes së ré: prej greqishtes *luludi* (e njajta domethanje); por âsht mât afër mendësh e kundërtë: se kët fjalë Grekët e kanë marrë prej Shqiptarëve. Krahaso dhe fjalën *farmak* (greq. *farmakion* „bar; helm”).

Ka edhe disa emna kafshësh: *gomar* (por jo *magar!*), si edhe emni *samar!* Mandej *skile* („dhelpën”), *dulfi*, e mandej pesku *qefell* (në veri; ashtu âsht edhe te Serbët e Kosovës). Edhe disa dukuní tjera natyrore kanë marrë emna prej greqishtes së ré: *erë*, *stom* („kep”); prej fjalës greqishte *stoma* „*gøjë*”; krah. fjalën *buzë* me të njajtën domethanje), *livadh* (*luath*), *kakariz*.

Gjithashtu edhe disa emërtime në lidhje me trupin e njeriut kanë emna greqisht: *kurm* (dhe *kurma* — gjak në pjesën e parë përmban emnin *kurm*, dhe nuk ka origjinë sllavishte, si pat mendue *Meyer-i*, por të greqishtes së ré), *p(ë)llamë*, *mustaqe*, *lehonë*, *flamë*, *magjepsun* (në Shqipnë të mesme).

Mâ në fund, mund të përmendim edhe shprehje tjera të ndryshme të kësaj origjine: *pastri*, *stivue*, *koptisë*, *lypsë*, (por jo *lyps* „mendicante”; *lyps* âsht fjalë vendase!), *hartue*, *sosë* (*sosmë*), *firë*, *plym* (*plim*), *fyskë* („noce cattiva” simbas Cor-dignanos — „arrë e prishtë” — sh. përkth.).

Edhe shprehjet shum të përhapuna për me thirrë burrat e gratë: *morë*, *orë* (mo'zot...); *mori*, *moj* — kanë origjinë greke. Edhe në sërbishte *morë* (*mori* për gjini femnore) kanë të njajtën origjinë, rasa thirrore (vokativi) e emnit në greqishte *moros* (f. *mori*), që do të thotë „i marrë, budallë”. Mâ vonë kjo domethanje e shëmtuet humbi si te Shqiptarët, ashtu edhe te Sllavët — dhe mbet vetëm si shprehje për thirrje.

Simbas llogaris së Thumb-it ka afër 200 fjalë të greqishës së ré, që dihen në Gegnì; studimet e mëvonshme kanë tregue se ka edhe mâ shum sosh, megjithse — në gjendjen e soçme të shkencës — nuk âsht e mundun me dhanë ndonji shifër të caktueme.

Si kemi përmendë, në tosknishte ndikesat greke janë edhe mâ të mëdha dhe shpesh edhe mâ të freskta.

Pos shprehjeve të marruna prej kishës ortodokse: *monastir*, *liturgjí*, *ikonë* (tosk. *korë*, dhe kjo shum e vjetër për shkak të ndrrimit të *r-s* në *n!*), *dhespot*, *katërrue*, *psalm*, *psalterë*, të cilat mâ i kemi përmendë, po shtojmë edhe: *konizmë* (= *ikonë*), *dhiak*, *igumen* („kujdestar manastiri”), *parais*, *profiti* („profetí”), *patericë* („skeptri i peshkopit”), *panajir* („panagjyr”) ...

Prej termave të lamis së kulturës materiale mund të përmendim toskizmat: *kamare*, *karshidhomë*, *parëdhomë*, *katinë* („bravë”); prej latinishtes *catena*, por me anë të Grekëve), *llos* („levë”), *mandile* [e dorës] („fazzoletto”), *molivë* („laps”), *tigan*, *skarë*, *voz(g)ë*, *qitharre*, *pisë* („peshkve”), *sternë* („cisterne”), *kuzinë* („kuzhina”); fjala ka origjinë italiane, por ka ardhë me anë të Grekëve). Nga lamija e jetës shoqnore: *pramatar* („tregtar — shitetës”), *pronie*, *prikë* („paja e nuses”); fja-la shqipe *përqí* ka ardhë nëpërmjet të serbishtes!). Por edhe fjalët: *nisí* („ujdhesë”), *steré* („tokë”), *vallto* („baltë”); ka gjasë se kët fjalë Grekët e kanë marrë prej Sllavëve, por Shqiptarët sigurisht prej Grekëve), *oreks* („apetit”), *oftikë* („tuberkuloz”), *tërfil* („tërfojë”), *nojmë* („isharet”), *kukllë* („nuse e vogël”), *modhë* („moda, kapricë, fantazí”) dhe shum tjetra. Kuptohet se nëndialektet tosknishte në teritorin grek, e pjesërisht n’Italín jugore, marrin nji sasi të madhe fjalësh së greqishtes së ré — e shpesh edhe fare „të panevojshme” sa i përket pastërtis së gjuhës.

Kjo parashtresë s’do t’ishte e plotë, sikur të mos merrshim parasysh edhe greqizmet e gjuhës shqipe jashtë fjalorit,

domethanë në sistemin gramatikuer. Iliologu dhe albanologu italian V. Pisani është i mendimit se kësot ndikese greke ka pasë qysh në të kaluemen e lashtë — në lamen e sistemit të fonetikës shqipe: ndrrimi i *ln* në *l* (*valë* në lidhje me fjalën sllavishte — *vlna*, litavishte *vilna*) dhe zhdukja e *v-s* së vjetër mbrapa bashkëtinglloreve (*derë*, në lidhje me fjalën rusishte *dver*, hindishte *dvar*). Mendohet se shqyptimi i bashkëtingllores që në tosknishtet është shum e butë (as si ç, as si č sërbisht, por si maqedonisht: *kuk'a*) shkaktue prej ndikesës greke.

Në sintaksën e të gjitha gjuhëve të Ballkanit ka plot ndikesa të greqishtes së ré. Këtë e ka tregue sistematikisht ballkanologu i madh danez K. Sandfeld-i. Natyrisht, kjo vlen edhe për gjuhën shqipe. Mâ së pari ndërtimi i futurit me *do* (të): *do* të *shkruaj* është pasojë e ndikesës greke. Edhe Grekët e ndërtojnë futurin me foljen ndihmtare që ka të njajtën domethanje me *do* (*thëllo*). Humbja e infinitivit në dialektin tosknisht është gjithashtu „ballkanizëm” që u detyrohet Grekëve, mbasi sod Grekët nuk kanë mâ infinitiv (*krahaso a- më të pi* dhe greqisht *dos mon na pio*). Analiza e imtë e sintaksës së gjuhës shqipe i qet në dritë edhe greqizmat tjera të këtij lloji; por na s'mund të hyjmë mâ fellë.

S'ka kurrfarë dyshimi se ndamja fetare e Shqiptarëve prej Grekëve ka bâ që edhe ndikesa gjuhsore e Grekëve ndaj Shqiptarëve të mos jetë aq sa do t'ishte, tue marrë parasysh pozitën udhëheqse të Grekëve në qytetnimin ballkanik (madje edhe europian). Vetëm Toskët ortodoksë ia kanë hapë gjatë shekujve derën ndikesës gjuhsore greke në Shqipnë. Nji gjâ e ngjajshme mund të konstatohet edhe te Sllavët e jugut: ndikesa greke, që është mjaft e madhe te Sërbët e Malazezët ortodoksë — te Kroatët katolikë është fare e vogël, gati e pandieshme. Muhamedanizmi dhe katolicizmi te Shqiptarët kanë qenë nji pritë e fortë prej ndikesës gjuhsore të Greqis ortodokse, megjithse, sikurse pamë — është larg mendësh se kanë mundë me e paralizue plotsisht.

Në lidhje me të gjitha këto, ka randsi të madhe me përmendë edhe nji fakt: ndërmjetsija e Serbëve dhe e Malazezëve në mes të Grekëve dhe të Shqiptarëve, me fjalë tjera, ka nji mori fjalësh të greqishtes së ré që Shqiptarët s'i kanë marrë direkt prej gjuhës greqishte, por me ndërmjetsin e gjuhës sërbokroatishë<sup>1</sup>). Përnjimend, Sërbët ortodoksë kanë qenë gjithashtu të ndamë fetarisht prej Shqiptarëve, katolikëve, e mandej edhe prej muslimanëve, por feudalizmi sërb, sikurse ai grek, gjatë Mesjetës sundoi herë mbas here pjesë të Shqip-

<sup>1)</sup> Ka, anasjelltas, edhe fjalë greqishte që Sërbët i kanë marrë me ndërmjetsin e Shqiptarëvet.

nis. Kështu hynë në gjuhën shqipe, sëbashku me fjalë thjesht sllavishte, nga gjuha sërbishte edhe disa greqizma, herëherë edhe mjaft të randsishme. Unë këtu nuk mund të hyj thellë në kët çashtje (së cilës mendoj me i kushtue studim të veçantë), por do të përmendi vetëm dy-tre shembuj: *përqí* prej sérb. *prćija*, e kjo prej greq. *priki-on*, *temelj* prej serb. *temelj*, e kjo greq. *themeli-on*, *pasul* prej serb. *pasulj*, e kjo greq. *pasuli-on* etj. Këtë mund të na e tregojë edhe analiza e thjeshtë gjuhsore — por kjo është çashtje e veçantë.

Më në fund është nevoja të them edhe disa fjalë për disa greqizma që kanë hy në gjuhën shqipe në mënyrë indirekte. Përveç ndërmjetsisë sllave — ka edhe tri rasa parimore.

1) T'ashtuquejtunat „europizma”, që kanë origjinë prej greqishtes së vjetër, por që edhe Shqiptarëve edhe popujve tjerë të Ballkanit u kanë ardhë nga Perëndimi (zakonisht prej gjuhës gjermanishte, italisht ose frangjishte). Shembuj të këtij lloji: *telefon*, *telegraf*, *demokratí*, *politikë*, *gjeografi*, *ekonomí*, etj.

2) Fjalët greqishte që Shqiptarët kanë marrë me anë të gjuhës latinishte ose italishte. Për shembull: fjala *kishë* prej lat. *ecclesia*, e kjo prej greqishtes *ekklesia* ose *bocë* prej italishës *boccia*, e kjo prej greqishtes *button*.

3) Fjalët greqishte që kanë mbërrijtë te Shqiptarët me anë të gjuhës turqishte. Bje fjala: *fener* prej turq. *fener*, e kjo prej greq. *fanari-on*; ose *krevet*, prej turq. *k(e) revet*, e kjo prej greq. *kravati-on* etj.

Por këto ndikesa indirekte (përveç në njifarë kuptimi ato sërbishte, ngase feudalizmi sérbi ka qenë vazhdimi i logjik i atij bizantin) — s'kanë randsi për çashtjen e ndikesës greqishte direkte ndaj Shqiptarëve, mbasi vetëm ndikesat gjuhsore direkte janë pasqyrë e vërtetë e marrëdhanteve ndërmjet popujve. Këto ndikesa indirekte i përmendëm vetëm për arsyenat thjesht linguistike e metodike.

Dr. Ivan POPOVIĆ